



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L-217

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR NJOHJEN E
KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE TË MJEKËVE,
STOMATOLOGËVE DHE ARKITEKTËVE NË KONTEKSTIN E
MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR NJOHJEN E
KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE TË MJEKËVE,
STOMATOLOGËVE DHE ARKITEKTËVE NË KONTEKSTIN E
MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ratifikimi i Marrëveshjes për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale të Mjekëve, Stomatologëve dhe Arkitektëve në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Marrëveshja për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale të Mjekëve, Stomatologëve dhe Arkitektëve në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore konsiderohet e ratifikuar me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Marrëveshja dhe shtojcat e saj janë pjesë integrale të këtij ligji.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-217
23 shkurt 2023

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës